



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/ L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008 dhe nenit 40 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kryetari Komunës propozon :

Në bazë të neneve 11, 12 par.12.2 shkronja c), 16 dhe 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 17 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 27 e datës 03.06.08 si dhe neneve 9 dhe 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të datës 26.09.2008, Kuvendi i Komunës së Lipjanit në mbledhjen e datës ____2014, miratoi këtë

PROJEKT

RREGULLORE PËR TARIFAT NDËRTIMORE

I. DISPOZITAT E PËRGJITHËSHME

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i miratimit të Rregullores për tarifrat ndërtimore (në vazhdim të tekstit: Rregullore) është që Komuna të krijoj burime të të hyrave vetanake buxhetore në pajtim me dispozitat e Ligjit mbi Financat e Pushtetit Lokal.

Neni 2 Objekti i rregullimit

Me këtë Rregullore përcaktohen tarifrat ndërtimore, obliguesit, procedura e pagesave si dhe procedura e ankesave, si vijon:

- 1.Tarifat rregullative me ndikim të drejtëpërdrejtë në infrastrukturë dhe
- 2.Tarifat rregullative për rritjen e densitetit në infrastrukturë

Neni 3 Fushëveprimi

Tarifat e përcaktuara me këtë Rregullore i zbaton Drejtorati për planifikim, urbanizëm dhe mbrojtje të mjedisit.

Neni 4 Obliguesit

Obligues të pagesës të tarifave të përcaktuara me këtë rregullore janë personat fizik dhe juridik kërkesat e të cilëve miratohen për leje ndërtimore..

II. TARIFAT

Neni 5 Tarifa rregullative me ndikim të drejtëpërdrejtë në infrastrukturë

1.Kjo tarifë do të aplikohet pas kërkesës të aplikuesit për leje ndërtimore, në rastet kur Komuna dhe aplikuesi lidhin Marrëveshje zhvillimore për infrastrukturë në tokën ku do të ndërtohet objekti për të cilin kërkohet leja ndërtimore, sipas së cilës Komuna obligohet për ndërtimin e infrastrukturës.

2.Aplikuesi për leje ndërtimore, konform paragrafit paraprak, duhet të paguaj tarifën rregullative me ndikim të drejtëpërdrejtë në infrastrukturë në lartësinë e kostos së shpenzimeve të Komunës për ndërtimin e infrastrukturës.

Neni 6 Tarifat rregullative për rritjen e densitetit të infrastrukturës

1.Obligues të pagesës të kësaj tarife janë aplikuesit për leje ndërtimore për objektet e banimit, ndërtim i cili rritë njësitë banuese në Komunë.

2. Kjo tarifë nuk do të zbatohet për leje ndërtimore për vetëm një objekt të aplikuesit deri në 200 m².

3.Këtë tarifë e aplikon dhe e pëcakton Drejtorati për planifikim, urbanizëm dhe mbrojtje të mjedisit, sipas formulës në vijim:

Metrat katror të objektit të banimit për të cilin lëshohet leja ndërtimore pjesëtohen me numrin 50 (sipërfaqe e supozuar për një banues) dhe shumëzohen me vlerën e shpenzimeve të pritura për shërbime arsimore, shëndetësore, kulturë, rini dhe sport për kokë banori sipas Buxhetit të vitit aktual.

4.Vlerën e shpenzimeve të pritura për shërbime arsimore, shëndetësore, kulturë, rini dhe sport për kokë banori sipas Buxhetit të vitit 2014 është 118.15 €.

5.Kalkulimin e kësaj tarife për vitet në vijim, në pajtim me paragrafin 3 të këtij neni, do ta bëjë Drejtorati për planifikim, urbanizëm dhe mbrojtje të mjedisit duke u bazuar në shënimet zyrtare të Drejtoratit për buxhet dhe financa për vlerën e shpenzimeve të pritura për shërbime arsimore, shëndetësore, kulturë, rini dhe sport për kokë banori sipas Buxhetit të vitit aktual.

III. PROCEDURA E ANKESAVE

Neni 7 Kërkesa për rishqyrtim dhe ankesa

1 Obliguesi, i pakënaqur me lartësin e caktuar të tarifës sipas kësaj Rregulloreje, mund të

parashtrorë kërkesë për rishqyrtim ose ankesë në pajtim me dispozitat e Ligjit për procedurën administrative.

IV. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 8 Hyrja në fuqi

1. Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe pas publikimit në web faqen e Komunës.

2. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohen dispozitat të cilat i rregullojnë tarifat ndërtimore në Rregulloren për taksat dhe tarifat komunale 15Nr.434-4250 e datës 12.03.2013 dhe Rregulloren për ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Rregulloreje 15Nr.434-10234 e datës 09.08.2013.

1Nr. _____
Lipjan , më _____

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

KRYESUESI I KUVENDIT
Vlora Limani-Hajnuni

Arsyetimi

Projekti i kësaj Rregulloreje është i bazuar në dispozitat e nenit 17 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 27 e datës 03.06.08

Dispozita e nenit 17 thekson:

17.1 Përmes një rregulloreje, komuna mund të vendosë tarifa të cilat caktohen me qëllim të kompensimit të shpenzimeve të komunës për ndërtimin, përmirësimin, zgjerimin ose riparimin e infrastrukturës komunale, nëse këto masa bëhen të nevojshme si pasojë e drejtëpërdrejtë e (i) ndërtimit të ndërtesave të reja ose (ii) zgjerimit ose rehabilitimit të konsiderueshëm të ndërtesave ekzistuese.

17.2 Nëse ndërtimi, zgjerimi ose rehabilitimi i sipërpërmendur shkakton rritjen e numrit të njësisve banuese në komunë, komuna mundet, përmes një rregulloreje, të vendosë tarifa të cilat duhet të paguhet për shkak të ndikimit që ka kjo rritje e popullsisë në shërbimet arsimore, shëndetësore dhe shërbimet e tjera të cilat ofrohen nga komuna.

Duke u bazuar në dispozitën paraprake, me këtë Projekt parashifen tarifat, si vijon:

- 1.Tarifa rregullative me ndikim të drejtëpërdrejtë në infrastrukturë dhe
- 2.Tarifa rregullative për rritjen e densitetit në infrastrukturë.

Tarifa rregullative me ndikim të drejtëpërdrejtë në infrastrukturë e përcaktuar në nenin 5 propozohet konform nenit 17 par.1 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal dhe nenit 9 të Udhëzimit Administrativ nr.22/2012 të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor mbi taksat administrative për lëshimin e lejes së ndërtimit dhe tarifat për rregullimin e infrastrukturës.

Sipas dispozitës së nenit 9 par.1 të Udhëzimit të lartëcekur, organi kompetent mundet pas aplikimit për leje ndërtimore të një personi që ka interes juridik në tokë ndërtimore, të hyjë në një marrëveshje me atë person për sa i përket zhvillimit të asaj toke.

Tarifa rregullative për rritjen e densitetit në infrastrukturë e përcaktuar në nenin 6 propozohet konform nenit 17 par.2 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal dhe nenit 10 të Udhëzimit të lartëcekur administrativ sipas të cilit është paraparë formula për vlerësimin e tarifave rregullative për rritjen e densitetit të infrastrukturës.

Bazuar në dispozitat e nenit 6 par 3 të Udhëzimit Administrativ nr.22/2012 të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor mbi taksat administrative për lëshimin e lejes së ndërtimit dhe tarifat për rregullimin e infrastrukturës:

Komuna duhet të publikojë tarifat rregullative për rritjen e densitetit të infrastrukturës si dhe kalkulimet në portal më së largu 60 ditë.

Gjatë kësaj periode Komuna duhet të inkurajoj dhe të lejoj komentet publike për propozimin e ndryshimeve si përmes portalit ashtu edhe përmes dorëzimit të shkresave për Departamentin e urbanizmit.

Tarifat bëhen të plotëfuqishme më së largu 30 ditë pas përfundimit të periudhës për komente.

Për të vepruar konform dispozitës së lartëcekur, është hartuar kjo Projekt Rregullore e veçantë për tarifat ndërtimore.

Lipjan, më _____ 2014

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti